



Kosovar Center for Security Studies



Llogaridhënie apo jo?

Menaxhimi i parasë publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë

Shkurt, 2014



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni
i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)



Kosovar Center for Security Studies

Llogaridhënie apo jo?

Menaxhimi i parasë publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë

Shkurt, 2014



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni
i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Skender Përteshi

Redaktimi i brendshëm: Mentor Vrajolli

Redaktimi i jashtëm: Shpend Kursani

Lekturimi gjuhësor në shqip: Fjolla Raifi

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit 2011/04-L-065

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë dhe përmes asnjë mjeti elektronik, mekanik apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi.

Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
HYRJE	7
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
METODOLOGJIA	9
KAPITULLI I	
1. BAZA LIGJORE PËR RREGULLIMIN E LLOGARIDHËNJES FINANCIARE TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË	10
KAPITULLI 2	
2. GJENDJA FAKTIKE DHE MATJA E NIVELIT TË IMPLEMENTIMIT TË LLOGARIDHËNIES FINANCIARE NË KOSOVË.....	12
2.1. Matja e nivelit të menaxhimit dhe efikasiteti i realizimit të shpenzimit të buxhetit nga ana e institucioneve të sigurisë	12
2.2. Funkionimi i prokurimit publik në sektorin e sigurisë në Kosovë	14
A. Prokurimi Publik në MPB dhe PK.....	15
B. Prokurimi Publik në MFSK.....	16
C. Trajtimi i Ankesave nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit.....	17
2.3. Funkionimi i sistemit të auditimit të brendshëm dhe inspektimit në Sektorin e Sigurisë.....	20
A. Auditimi i Brendshëm në kuadër të MPB.....	20
B. Auditimi i Brendshëm në kuadër të Policisë së Kosovës	21
C. Auditimi i Brendshëm në MFSK.....	22
Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nga ana e Institucioneve të Sigurisë	24
Niveli i Adresimit të Rekomandimit të ZAP nga ana e MPB dhe PK.....	24
Niveli i Adresimit të Rekomandimit të ZAP nga ana e MFSK.....	25
Rekomandimet:.....	27
Bibliografia:.....	28
Legjisllacioni:.....	28
Raportet dhe Publikimet:	29
Intervistat:	30

LISTA E SHKURTESAVE

- AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
- AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit
- AQP - Agjencioni Qendror i Prokurimit
- BKS - Barometri Kosovar i Sigurisë
- BRSB - Brigada për Reagim të Shpejtë
- DSP - Drejtoria për Standarde Profesionale
- EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
- FSK - Forca e Sigurisë së Kosovës
- IFSK - Inspektorati i Forcës së Sigurisë së Kosovës
- IPK - Inspektorati Policor i Kosovës
- KA - Komitetet e Audimit
- KFOR - Forca për Kosovën
- KFT - Komanda e Forcave Tokësore
- KK - Kuvendi i Kosovës
- KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- KTD - Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës
- LPP - Ligji i Prokurimit Publik
- LSHC - Ligji për Shërbyesit Civil
- LVV - Lëvizja Vetëvendosje
- MF - Ministria e Financave
- MFP - Menaxhimi i Financave Publike
- MFSK - Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
- MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
- NJAB - Njësitet e Auditimit të Brendshëm
- NJQH - Njësia Qendrore Harmonizuese
- OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile
- OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
- PK - Policia e Kosovës
- QKSS - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
- QKSP - Qendra e Kosovës për Siguri Publike
- RSSS - Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
- ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
- KPO - Kapacitet e Plota Operacionale
- NAT - Ekipi Këshilldhënës i NATO-së

HYRJE

Mbikëqyrja dhe kontrolli i brendshëm financiar i institucioneve të sigurisë në vend, ka për qëllim garantimin e shpenzimeve të fondeve publike në mënyrë të drejtë, transparente dhe efektive. Po ashtu, menaxhimi i drejtë dhe efikas i financave publike siguron përdorimin e fondeve publike nga institucionet shtetërore sipas parimeve dhe standardeve të parashtruara në legjislacionin përkatës.

Gjatë viteve 2010-2012, institucionet e Kosovës kanë bërë progres të pjesshëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin e financave publike. Rol për këtë kanë pasur ndërtimi i mekanizmave të brendshëm të kontrollit, si dhe forcimi i tyre me nënpunës të rinj. Kontribut për një gjë të tillë kanë dhënë edhe mekanizmat e jashtëm të mbikëqyrjes, siç janë: komisionet parlamentare për mbikëqyrjen e institucioneve përkatëse (të cilët mbajnë edhe rolin kyç në aprovimin e buxhetit si dhe mbikëqyrjen e buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës); Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), Organet e Prokurimit Publik (OPP), dhe Agjencia Kundër-Korrupsionit (AKK). Mirëpo, gjetjet tregojnë se institucionet e sigurisë edhe më tutje janë të mbërthyer nga mos-funksionimi adekuat i mekanizmave të brendshëm të kontrollit si dhe mos-menaxhimi adekuat i financave publike. Një gjë e tillë është vërejtur edhe në performancën e disa institucioneve të sigurisë, duke rezultuar me rënien e vazhdueshme të besueshmërisë së qytetarëve ndaj atyre institucioneve. Kjo pasi që tashmë jo pak raste të keqpërdorimeve janë të njohura edhe për publikun e gjerë. Mjafton të përmenden vetëm disa nga të si: vjedhja e dhomave të dëshmime në Policinë e Kosovës (Prishtinë 2009; Pejë 2013); skandali i përfolur korruptiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme me kompaninë Austriake rreth kontraktimit të saj për prodhimin e pasaportave biometrike dhe ngjarje tjera të ngjajshme.

Vlen të theksohet se përveç impaktit negativ që ka keq-menaxhimi dhe keq-përdorimi i financave publike në performancën e institucionit përkatës, një gjë e tillë ka impakt negativ edhe në proceset integruese në të cilat Kosova aspiron. Kjo pasi, siç dihet, ngritja e kontrollit dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike është një nga parakushtet për integrim në BE. Si Bashkimi Evropian (BE) po ashtu edhe NATO kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë në menaxhimin e fondeve publike dhe mbajnë rregulla pa implementimin e të cilave është vështirë të besohet se do të arrihet progresi i dëshiruar qoftë në procesin e liberalizimit të vizave, nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asocim, apo edhe eventualisht në krijimin e sektorit Kosovar të mbrojtjes e fillimin e marrëdhënieve kontraktues me NATO-n.

Prandaj, synimi i këtij studimi është që të vlerësoj dhe përpiloj rekomandime përkatëse në lidhje me performancën e institucioneve të sigurisë në dimenzionin e menaxhimit financiar. Një gjë të tillë, hulumtimi synon ta arrijë përmes matjes së efikasitetit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në raport me mënyrën e realizimit të vijave buxhetore të dedikuara për këto institucione. Ndërsa, gjetjet e këtij hulumtimi synohet të përdoren si instrument për avokim në lidhje me përmirësimin e performancës institucionale në sektorin e Sigurisë.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky hulumtim ka për qëllim që të analizoj funksionimin e llogaridhënies financiare në sektorin e Sigurisë në Kosovë duke promovuar fuqizimin e vazhdueshëm të saj.

Hulumtimi është i përqendruar kryesisht në gjendjen e tanishme dhe trendët ekzistuese të vijueshmërisë së kësaj sfere në këtë sektor. Andaj, në aspektin kohorë, pikë referuese të këtij hulumtimi janë kryesisht periudhat 2010-2013. Po ashtu, edhe fusha të cilën mbulon ky hulumtim është e limituar duke përfshirë vetëm menaxhimin financiar, prokurimin dhe auditimin në institucionet në vijim: Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Për arsye të specifikave institucionale dhe mungesës së transparencës të definuar me ligji, ekipi hulumtues qëllimisht ka anashkaluar përfshirjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Pavarësisht se, ekipi hulumtues mendon që mungesa totale e transparencës financiare të këtij institucioni është në shpërputhje me parimet e llogaridhënies për shpenzimin e fondeve publike.

Analiza gjen se edhe në sektorin e sigurisë vlen po e njëjta bazë ligjore e cila është e aplikueshme edhe në sektorët e tjerë. Pavarësisht ekzistimit të kësaj baze, disa dobësi në legjisllacion janë vërejtur, gjë që, ekzistimi i tyre do të lenë hapësirë të mëtejme për interpretim në dëm të fondeve publike. Njëri ndër segmentet kyçe të kontrollit financiar - auditimi i brendshëm llogaritet të jetë në fazën fillestare të konsolidimit. Njësitë e auditimit të institucioneve të sigurisë kanë numër të vogël të personelit krahasuar me numrin e stafit dhe volumin e punëve në sektorin financiar. Si pasojë, numri i auditimeve mbetet relativisht i ulët duke targetuar vetëm disa nga fushat më të rëndësishme.

Si dobësi kyçe të këtyre institucioneve vërehet mos-hartimi i planeve adekuate për realizimin e shpenzimeve dhe mos-efikasiteti i realizimit të shpenzimeve sipas planeve. Kjo gjë vështirëson mbikëqyrjen e shpenzimeve dhe menaxhimin financiar në këtë sektor. Menaxhimi i prokurimit publik është në nivelet shqetësues. Problemet e identifikuara kryesisht kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit të ofertave, paqartësitë në specifikimin e njësive gjatë aplikimit si dhe vështirësitë e shumta në mbikëqyrjen e prokurimit publik të sektorit të sigurisë. Në anën tjetër, nga vendimet e marra nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), vërehet se në pothuajse 50% të rasteve ankesat e ngritura nga operatorët e ndryshëm ekonomik rezultojnë të jenë të bazuara në fakte duke rikthyer procesin e tenderimi qoftë në ri-vlerësim apo në ri-tenderim.

METODOLOGJIA

Gjetjet dhe vlerësimi i bërë në këtë raport bazohen në metoda të ndryshme të mbledhjes së të dhënave. Kryesisht është përdorur metoda kualitative për mbledhjen e të dhënave ku përfshihet: analizimi i legjislacionit primar dhe sekondar i cili rregullon fushën e financave publike në Kosovë; raportet e brendshme të publikuara nga ana e institucioneve përkatëse të cilat pasqyrojnë menaxhimin institucional të tyre; raportet e publikuara nga ana e institucioneve të pavarura mbikëqyrëse (Zyra e Auditorit Gjeneral; Agjencioni Anti-Korrupticon si dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit); raportet e komisioneve parlamentare (për siguri, buxhet si dhe për mbikëqyrje të financave publike); si dhe raportet dhe analizat e publikuara nga ana e organizatave lokale e ndërkombëtare.

Po ashtu, për mbledhjen e gjetjeve në lidhje me hartimin e këtij raporti janë marr për bazë edhe procesverbalet e mbledhura gjatë monitorimit të vazhdueshëm të mbledhjeve dhe aktiviteteve të tjera të institucioneve të sigurisë; janë zhvilluar gjithsej 10 intervista të gjysmë-strukturuara me akterët kryesor të kësaj fushe; si dhe janë organizuar 4 fokus grupe me zyrtar të lartë të institucioneve përkatëse. Përveç metodave kualitative, ekipi hulumtues për draftimin e këtij raportit ka marr për bazë edhe burime të ndryshme kuantitative si statistikat e ndryshme të marra nga MPB dhe perceptimet e qytetarëve të mbledhura nga QKSS në programin e Barometrit Kosovar të Sigurisë.¹

¹ Barometri i Sigurisë është dizajnuar dhe realizuar nga QKSS si instrument inovativ që botohet dy herë brenda vitit dhe i cili ka qëllim që të sjellë në sipërfaqe opinionet e qytetarëve rreth sigurisë dhe drejtësisë sikurse edhe sfidave të sigurisë me të cilat ballafaqohet Kosova.

KAPITULLI I

1. BAZA LIGJORE PËR RREGULLIMIN E LLOGARIDHËNJES FINANCIARE TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

Kosova ka përmbushur relativisht bazën ligjore e cila rregullon menaxhimin e financave publike. Korniza ligjore në përgjithësi është në harmoni me legjislacionin e BE-së. Ky rregullim kryesisht bëhet përmes ligjeve bazike të cilat janë të aplikueshme në të gjithë sektorët shtetëror, përfshirë edhe sektorin e sigurisë. Ligjet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për Auditimin e Brendshëm, si dhe Ligji për Prokurimin Publik, për të cilat diskutohet në vazhdim.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike është miratuar në vitin 2003, dhe i njëjti i është nënshtruar amendamenteve fillimisht në vitin 2008 pastaj në 2012 dhe së fundi në 2013. Ky ligj ka krijuar hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e kontrollit efikas dhe efektiv mbi financat publike, si dhe definojnë në detaje procedurat e paraqitjes së propozimeve buxhetore dhe të raportimit.² Ky ligj në mënyrë të kënaqshme rregullon mandatin e mekanizmave institucional të mbikëqyrjes dhe kontrollit të financave publike.³ Po ashtu, ligji obligon çdo organizatë buxhetore të ketë një zyrtar të prokurimit, një zyrtar kryesor financiar, dhe një mbikëqyrës të caktuar i cili përcjellë kryerjen e punëve sidomos ato të investimeve kapitale, duke krijuar bazë të mjaftueshme ligjore sa i përket menaxhimit të financave nga ana e institucioneve publike.⁴

Sfera e prokurimit publik është e rregulluar me **Ligjin për Prokurim Publik (LPP)** i cili është kompletuar në vitin 2010.⁵ Fillimisht, ky ligj ka qenë mjaft i kritikuar si nga vet departamentet për prokurim, po ashtu edhe nga institucionet e jashtme mbikëqyrëse duke u shndërruar në pengesë kryesore për funksionimin adekuat të prokurimit publik. Mangësia kryesore e këtij ligji qëndronte në faktin se ligji favorizonte ofertën ekonomikisht më të favorshme dhe çmimin më të ulët. Këto kritere shpesh kanë pamundësuar përzgjedhjen e operatorëve më të përgjegjshëm ekonomik. Andaj, si rezultat i mos vlerësimit të mirë të ofertave shpeshherë ka rezultuar në shkaktimin e vonësive në kryerjen e punëve nga ana e operatorëve përfitues ekonomik. Sidomos kur flitet për institucionet e sigurisë, ligji i prokurimit lejoi hapësira të mëdha ligjore në të cilat mundësohen keqpërdorimet. Më specifikisht, ligji mundëson shmangie të procedurave të rregullta të prokurimit kur kemi të bëjmë me kontrata specifike në të cilat kërkohen masa të veçanta të sigurisë si dhe në rastet kur me vendim të organe-

² Ligji për Menaxhimin e Financave Publike Neni 6

³ Ibid, Neni 12

⁴ Ibid, Neni 11, 12, 13, 14

⁵ Ligji për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 15.10.2010

ve përkatëse të Qeverisë së Kosovës miratohet klasifikimi i lëndëve të kontratës në fjalë si sekret.⁶ Megjithatë, rregullimi i këtij segmenti vetëm me një nen lenë hapësirë të mëdha për keqpërdorime. Sfera e sigurisë dhe e mbrojtjes do të duhej të rregullohej së paku me një kapitull, gjithmonë në kuadër të ligjit civil të prokurimit publik.

Për të ju shmangur mangësive ekzistuese, ligji në vazhdimësi i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve të shpeshta. Fillimisht u ndryshua në vitin 2011, e më pas edhe në vitin 2013. Qëllimi i ndryshimeve ishte përmirësimi i procedurave të prokurimit dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare të prokurimit, respektivisht me Direktivat 2004/172 dhe 2004/183 për Prokurim Publik të BE-së.⁷ Deri më tani ndryshimet në fjalë më tepër kanë pasur për qëllim rregullimin e vlerësimit të ofertesit, duke shënuar përmirësim të dukshëm në këtë pikë. Ndërkohë, ende nuk ka ndonjë ndryshim substancial sa i përket rregullimit të prokurimit kur kemi të bëjmë me prokurimin e kontratave më rëndësi të veçantë, respektivisht zgjerimit të “nenit 3” në një kapitull të veçantë të ligjit.

Në anën tjetër, **Ligji për Auditimin e Brendshëm** i miratuar në vitin 2009 paraqet bazë të mjaftueshme juridike sa i përket rregullimit të auditimit të brendshëm. Nëpërmjet këtij ligji rregullohen përgjegjësitë dhe mandati i njësive të brendshme të auditimit, si dhe garantohet pavarësi e plotë gjatë ushtrimit të mandatit nga ana e auditorëve të brendshëm.⁸ Qëllimi i këtij Ligji është vendosja e një kontrolli më të madh dhe më efikas në mbikëqyrjen e shpenzimit të financave publike si dhe sigurimin e nënshtimit të të gjitha shpenzimeve publike ndaj auditimit të brendshëm në mënyrë sistematike. Ligji po ashtu rekomandon ndërtimin e Komiteteve të Auditimit, të cilat krijohen në çdo organizatë publike sipas procedurave dhe kriterëve të parapara me Ligjin për Auditimin e Brendshëm. Komiteti i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.⁹

⁶ Ibid: Neni 3

⁷ Është bërë ndryshimi i Ligjit të Prokurimit Publik i cili është miratuar në qeveri, dhe është dërguar në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim të mëtutjeshëm.

⁸ Ligji për Njësitet e Brendshme të Auditimit- neni 4

⁹ Ibid: Neni 7

KAPITULLI 2

2. GJENDJA FAKTIKE DHE MATJA E NIVELIT TË IMPLEMENTIMIT TË LLOGARIDHËNIES FINANCIARE NË KOSOVË

Qëllimi i këtij kapitulli është që të elaboroj gjendjen faktike të llogaridhënies në Kosovë duke u bazuar në tre indikatorët kryesor. Këta indikatorë do të analizohen në seksione të ndara duke u bazuar në radhitjen në vijim: 1) niveli i menaxhimit dhe efikasiteti i realizimit të shpenzimit të buxhetit; 2) funksionimi i prokurimit publik dhe 3) funksionimi i sistemit të auditimit të brendshëm dhe inspektimit.

2.1. Matja e nivelit të menaxhimit dhe efikasiteti i realizimit të shpenzimit të buxhetit nga ana e institucioneve të sigurisë

Gjatë tre viteve të fundit, niveli i realizimit të buxhetit nga ana e institucioneve të sigurisë ka qenë relativisht i kënaqshëm. Si rrjedhojë, **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)**¹⁰, me përjashtim të vitit 2012 kur buxheti ishte realizuar vetëm 85%, 2010-2013 ka realizuar mbi 90% të buxhetit të planifikuar.¹¹ Ajo çka mbetet shqetësuese është koncentrimi më i madh i realizimit të shpenzimeve gjatë tre muajve të fundit të vitit. Një gjë e tillë është evidente sidomos kur kemi të bëjmë me shpenzimet kapitale. MPB nuk ka arritur që ta shpenzojë buxhetin e saj në mënyrë konsistente, të njëtrajtshme dhe në harmoni me planin e tyre të prokurimit përgjatë gjithë vitit edhe në vitin 2013. Shembull më tipik është fakti se në tre vitet e fundit, pothuajse rreth 50% të obligimeve për investimet kapitale janë realizuar gjatë muajit dhjetor.¹² Një gjë e tillë krijon hapësirë për lëshime dhe mangësi në procedurat e realizimit të obligimeve si dhe pamundëson një kontroll efikas të brendshëm të shpenzimeve të fondeve publike. Për arsye krejtësisht të njëjta, kjo ministri po ashtu ka dështuar ti realizoj një numër të madh pagesash brenda vitit buxhetor, duke u detyruar që të njëjtat obligime të i bart në vitin vijues. Shembuj konkret për këtë është viti 2011 kur MPB-ja kishte 3.4 milion euro borxhe të mbetura nga viti paraprak, kurse në vitin 2012 ato ishin rreth 2.4 milion. Për shkak të këtyre problemeve të shfaqura, MPB shpesh herë është akuzuar për paaftësi në përpilimin e planeve të duhura financiare.¹³ Ndërkohë, skandalet e shumta me të cilat është përballur kjo ministri gjatë tre viteve të fundit ngjallin dyshime se në raste të caktuara lëshimet e tilla bëhen në mënyrë të qëllimshme, duke

¹⁰ Në kuadër të së cilës operon edhe Policia e Kosovës

¹¹ Raporti i ZAP për MPB dhe PK për vitet 2010, 2011 dhe 2012

¹² Ibid:

¹³ Të dhëna nga mbajtja e Fokusgrurit më datën 21 Janar 2014

vështirësuar kështu kontrollimin e rrjedhës së parave të shpenzuara dhe krijimin e hapësirave në të cilat do mund të përvetësoheshin një pjesë e fondeve.

Në, fund duhet potencohet fakti që për shkak se buxheti i cili ndahet nga Qeveria e Kosovës për MPB dhe PK edhe më tutje është i përbashkët për këto dy institucione, kjo mund të ketë ndikim si në pavarësinë buxhetore në mes të këtyre dy institucioneve ashtu edhe në mbikqyrjen e prokurimit publik dhe auditimin e këtyre shpenzimeve.

TABELA 1: Pasqyra elebaruese në lidhje me efikasitetin e realizimit të shpenzimit buxhetorë nga ana e MPB (duke përfshirë gjithashtu edhe Policinë e Kosovës) gjatë tre viteve të fundit:				
MPB - Pasqyra ndër vite:	Buxheti i final për vitin	Buxheti i shpenzuar	Borxhet	Përqindja e buxhetit të shpenzuar gjatë 3 muajve të fundit
2010	81.240.159 €	78.951.371 € apo 96 % e buxhetit final	X	67 % (investimeve kapitale)
2011	92,759,788 €	78,589,384 apo 85% e buxhetit final	3,413,749€ (të bartura në buxhetin e vitit 2012)	52 %
2012	95,323,043 €	89,213,798 € apo 85% e buxhetit final	2,473,281€ (të barturave buxhetin e vitit 2013)	50 % (investimeve kapitale)
Buxheti i shpenzuar nga MPB dhe PK	Buxheti i final për vitin 2	Buxheti i shpenzuar	Borxhet	Përqindja e buxhetit të shpenzuar gjatë 3 muajve të fundit

Situatë e ngjashme mbretëron edhe në **Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK)**. Edhe në këtë ministri, gjatë tre viteve të fundit, në nivel vjetor shpenzimi i buxhetit ka qenë i kënaqshëm. Me përjashtim të vitit 2013 ku realizimi i buxhetit ka qenë në masën 85%, në gjitha vitet tjera realizimi i buxhetit ka kaluar 90% të shumës së alokuar.¹⁴ Mirëpo edhe këtu vërehet një diskrepancë në mes të planifikimeve të bëra dhe përqendrimin kohor të realizimit të rrjedhës së shpenzimeve. Si rrjedhojë, gjatë tre viteve të fundit MFSK kishte shpenzuar rreth 50% të buxhetit të saj në tre-mujorin e fundit të vitit ndërkohë që edhe borxhet e mbetura nga viti në vit kapin një shumë jo të vogël të shpenzimeve kapitale. Shembull konkret mund të merret viti 2014, ku borxhi i trashëguar nga viti paraprak arrin shifrën e 450 mijë Euro.¹⁵ Ndërkohë, kur dihet që pagesa e obligimeve të trashëguar nga viti paraprak bëhet nga buxheti i vitit aktual, një gjë e tillë vetëm sa e ngarkon barrën institucionale të kësaj ministrie dhe ka implikime në planifikimin buxhetor të vitit. Andaj edhe tek kjo ministri, shpenzimi i ngutshëm i buxhetit në një hapësirë të shkurtër kohore si dhe vonesat në realizimin e tij ndikojnë direkt në realizimin efikas dhe në ushtrimin e një kontrolli të brendshëm efektiv të shpenzimeve.

¹⁴ Intervistë me Sekretarin e MFSK-së z. Shkelzen Sylja data 15 Janar 2014

¹⁵ Intervistë me Sekretarin e MFSK-së z. Shkelzen Sylja data 15 Janar 2014

TABELA 2:

Pasqyra elebaruese në lidhje me efikasitetin e realizimit të shpenzimit buxhetore nga ana e MFSK (duke përfshirë gjithashtu edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës) gjatë tre viteve të fundit:¹⁶

MFSK - Pasqyra ndër vite:	Buxheti i final për vitin	Buxheti i shpenzuar	Borxhet ndaj operatorëve ekonomik	Përqindja e buxhetit të shpenzuar gjatë 3 muajve të fundit
2010	29.384.264 €	27.653.592 € apo 94% e buxhetit	139.042 € (të bartura në buxhetin e vitit 2011)	56%
2011	33.674.299 €	31.239.208 € apo 93 % e buxhetit	237 485 € (të bartura në buxhetin e vitit 2012)	46 %
2012	34.311.877 €	33.008.268 € apo 96% e buxhetit	238.416 € (të bartura në buxhetin e vitit 2013)	47 %
2013	36.961.084€	32.345.714 € apo 86.7 % e buxhetit	440.481 € të bartura në buxhetin e vitit 2014)	Afro 45%

2.2. Funkcionimi i prokurimit publik në sektorin e sigurisë në Kosovë

Në Kosovë, prokurimi publik mbetet forma kryesore e shpenzimit të buxhetit përmes së cilës shpenzohet mbi 50% e buxhetit shtetëror.¹⁷ Andaj, ky sektor mund të jetë burimi kryesor i keqpërdorimeve të mundshme i fondeve publike. Çështja bëhet edhe më serioze kur dihet se luftimi dhe parandalimi i keqpërdorimeve në prokurimin publik është një proces tejet i vështirë sepse në procedurat e prokurimit publik janë të involvuar një mori faktorësh.¹⁸ Shqetësues mbetet privimi i konkurrencës së lirë në proceset e prokurimit publik për shkak të mungesës së 'mosinformit' në mënyrë të duhur të zyrtarëve të prokurimit publik lidhur me kompanitë e caktuara të cilat aplikojnë për tenderë të ndryshëm. Shqetësuese është edhe fakti se në institucionet e sigurisë shpeshherë kompanitë e njëjta janë përfitues të tenderëve publik. Kjo mund të ngjallë dyshime se persona të caktuar mund të jenë të përfshirë në konflikt të interesit me biznese të caktuara private. Po ashtu, në shumë raste, të njëjtit persona (pronar) aplikojnë me 3 apo 4 kompani me emra të ndryshëm për të njëjtin tender duke ndryshuar vetëm vlerat e çmimit.¹⁹ Andaj, luftimi dhe parandalimi i keqpërdorimeve në fushën e prokurimit publik kërkon një angazhim tepër të madh ndërinstitutional, cilësi të cilën institucionet e tona ende nuk e kanë arritur.²⁰

Në Kosovë janë gjithsej 166 autoritete që përdorin prokurimin publik, ku 5 prej tyre janë institucione të sigurisë: MPB, Polica e Kosovës (KP), MFSK, Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për

¹⁶ Ibid:

¹⁷ Raporti i Institutit Demokratik të Kosovës "Prokurimi Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme", Prishtinë Janar 2014

¹⁸ Ibid;

¹⁹ http://www.kdi-kosova.org/publications/RAporti%20MPB-se_KDI.pdf

²⁰ Intervistë me një zyrtar të lartë të MPB-së Tetor 2013

Inteligjencë.²¹ Në vijim do të elaborohet gjendja në prokurim vetëm në institucionet në vijim: a) MPB (në kuadër të së cilës do të elaborohet edhe Policia e Kosovës); b) MFSK (ku përfshihet edhe Forca e Sigurisë së Kosovës); si dhe c) në kuadër të një nën-seksioni të veçantë do të elaborohet edhe puna e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) në shqyrtimin e ankesave të ngritura ndaj institucioneve të sigurisë nga operatorët e ndryshëm ekonomik.²²

A. Prokurimi Publik në MPB dhe PK

Në kuadër të MPB-së ekziston departamenti i prokurimit i cili është kompetent që të menaxhoj dhe mbikëqyrë tërë procesin e prokurimit në këtë ministri. Megjithatë, deri më tani, funksionimi i Prokurimit Publik në këtë ministri ka qenë mjaft sfidues. Në vazhdimësi kjo ministri ka qenë e përfolur për një numër të madh parregullsish dhe aferave korruptive. Një ndër rastet ishte edhe ai i skandalit me pasaportat biometrike e cila kishte ndodhur në MPB në vitin 2012, ku dyshohej të jenë përvetësuar nga zyrtarët e kësaj Ministrie rreth 1.4 milion Euro mjete të taksapaguesve kosovar. Rasti në fjalë është ende në proces të hetimit nga ana e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Një rast tjetër i përfilitur ishte edhe rasti i ndërtimit të objektit të Agjencisë për Regjistrim Civil, ku fituese e këtij tenderi ishte operatori ekonomik për të cilin tashmë ka dyshime të bazuara se në ofertën e saj tenderuese kishte vendosur çmime fiktive absurde të cilat nuk përkonin as afërsisht me çmimet e tregut.²³ Më konkretisht, ofertuesi në fjalë në ofertë kishte ofruar dyer dhe dritare me çmim prej vetëm 5 euro, ndërkohë që çmimi i tregut ishte afërsisht 1500-2000 Euro. Ndërsa në anën tjetër, kishte paraparë çmimin astronomike për 1m3 beton e cila kapte vlerën rreth 999 Euro, ndërkohë që çmimi i tregut për këtë produkt ishte vetëm 150 Euro.²⁴ Përkundër gjithë këtyre defekteve që kishte oferta e këtij operatori, komisioni i vlerësimit çuditërisht e kishte shpallur fituese pa kërkuar fare ndonjë sqarim shtesë lidhur me këtë ofertë të çuditshme. Si dhe tenderët për blerjen e makinave për nevojat e Policisë së Kosovës e cila gjatë tre viteve (2010-2013) po përcillet me parregullsi dhe pakënaqësi nga ana e operatorëve ekonomik për shkak të leshimeve të ndryshme.

Mangësi në zbatimin e ligjit të prokurimit publik ishin vërejtur edhe tek grupi punues për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë i themeluar nga Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së të cilët kanë bërë monitorimin e zbatimit të LMFb nga ana e MPB-së dhe PK-së. Madje ky komision, në fund të vitit 2012 kishte ftuar për raportim edhe Ministrin e MPB-së për të raportuar në lidhje me gjendjen e prokurimit dhe skandalet e lartcekura që kishin ndodhur në këtë ministri dhe i cili nuk ishte përgjigjur kësaj kërkesë me arësimin se ky komision nuk ka për mandat të bëjë inspektime për financat publike të MPB dhe PK.²⁵ Në raportin e këtij komisioni vërehet

²¹ AKI nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik për shkak të specifikave të saj.

²² Arsyja e anashkalimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës është për shkak të bugjetit dhe relavancës së vogël që ky mekanizëm Këshillues ka. Ndërsa siç është shpjeguar në përmbledhjen ekzekutive, anashkalimi i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë është bërë për shkak të specifikave që ky institucion ka që e pamundëson qasjen në informata që kanë të bëjnë me prokurimin në këtë institucion.

²³ Për më shumë shih: <http://indeksonline.net/?FaqlID=2&LajmID=35952>

²⁴ Raportet e ZAP për MPB 2012

²⁵ Në këtë takim Ministri i MPB nuk kishte marrë pjesë në këtë dëgjim publik me arsyen se ky komision nuk ka kompetencë për të mbikëqyr financat publike të kësaj ministrie. Argumenti i tij ishte se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është komisioni përgjegjës.

se nga 10 kontratat qe ishin marrë si mostër për inspektim në të gjitha këto kontrata kishte lëshime të procedurave të prokurimit publik si dhe shkelje të ligjit për menaxhimin e financave publike.

Edhe raportet e Auditorit të Përgjithshëm vlerësojnë se në MPB gjatë gjithë procedurave të prokurimit publik janë vërejtur lëshime dhe mangësi në zbatimin e ligjit të prokurimit publik. Në shumë raste të procedurave të prokurimit publik ka qenë i përfshirë edhe konflikti i interesit dhe për pasojë disa ish-zyrtarë të MPB-së janë nën hetime apo kanë të hapura procedura gjyqësore në lidhje me çështjet e prokurimit.²⁶

Ndërkohë edhe në Polici të Kosovës, si njëra ndër shpenzueset më të mëdha nëpërmjet prokurimit publik, vërehet se ka pasur probleme të ndryshme në lidhje me prokurimin e financave publike. Në këtë institucion, përveç asaj që u cek në seksionin e menaxhimit të shpenzimit të financave publike ku vërehet një mbi-fokusim i shpenzimeve gjatë një periudhe të shkurtër kohore pran përfundimit të vitit buxhetor, e që gjithsesi ndikojnë negativisht në monitorimin e procesit të prokurimit, vërehet se ekzistojnë edhe probleme të tjera të cilat "lehtësojnë" mundësinë për keqpërdorime edhe në Polici. Madje, Auditori i Përgjithshëm kishte vërejtur se në kuadër të PK-së ka pasur një numër të madh të kontratave të lidhura ku shumica e përlogaritur ishte matur jo në total por në njësi. Gjithashtu, ishin vërejtur edhe raste të ndarjes së tenderëve, parregullsi të ndryshme në përgatitjen e specifikave teknike të ofertave duke ju referuar produktit specifik e duke favorizuar produkte të caktuara, si dhe përmbushja e obligimeve nga ana e PK-së ende para fillimit të implementimit të kontratës.²⁷ Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto indikatorë, mund të konkludohet se PK ka ngecje të mëdha në menaxhimin e prokurimit publik.

B. Prokurimi Publik në MFSK

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka bërë një progres të pjesshëm në menaxhimin e prokurimit publik viteve të fundit 2010-2013. Departamenti i Prokurimit funksionon në kuadër të MFSK-së dhe përbëhet nga 6 zyrtar (5 civil dhe 1 me uniformë).²⁸ Sikurse MPB, edhe kjo ministri përballat me sfida të mëdha në monitorimin e zbatimit të kontratave, si dhe me vlerësimin e ofertave.

Në këtë ministri problemet kryesisht janë të ndërlidhur me prokurimin e kontratave një burimore me procedurë të negociuar. Si rrjedhojë, në vitin 2012 FSK-ja kishte nënshkruar gjashtë kontrata me procedurë të negociuar, duke përdorur nën 3 të LPP-së i cili e rregullon këtë çështje. Këto kontrata ngërthenin pajisje kyçe të FSK-së siç janë: armët dhe municionet, uniformat për pjesëtarët, kontratat për fije optike, kontratat për makina për nevoja të veçanta (makina taktike), si dhe kontrata për digjitalizimin e ambienteve të FSK-së. Komisioni për vlerësimin e këtyre kontratave ishte i përbërë nga zyrtarë të prokurimit të MFSK-së, ekspert të fushës nga FSK-ja, si dhe përfaqësues të Ekipit Këshillues të NATO-s në Kosovë.²⁹ Ndërsa në vitin 2013, kjo ministri nuk prokuroi asnjë kontratë me procedurë të negociuar, pasi që kjo procedurë nuk morri miratimin e Qeverisë së Kosovës. Si rezultat i kësaj, MFSK më pas ka përdorur procedurën e negociuar të prokurimit publik por pa publikim të kontratës.

²⁶ Diskutimet gjatë interpelancës parlamentare të Minsitrit të Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi në Parlamentin e Kosovës- 2012

²⁷ Auditimi i Auditimit: Menaxhimi i Prokurimit në Policinë e Kosovës për vitin 2012, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Prishtinë, Maj 2013

²⁸ Intervistë me sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së z. Shkelzen Sylja- 15 Janar 2012

²⁹ Ibid:

Një tjetër problem shumë evident është edhe mos-implementimi i kontratave sipas zotërimeve për shkak të numrit të vogël të menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrjes së dobët të implementimit të projekteve të ndryshme të MFSK-së. Rast konkret është dyshimi për mashtrime apo involvimin e konfliktit të interesit nga një firmë vendore e cila ishte kontraktuar për të furnizuar FSK-në me pije dhe ushqim. Në këtë kontratë, kompania në fjalë ishte paraparë që të ofroj pije origjinale dhe në paketim jo më të madh se 0.5 l, kurse kompania kishte ofruar pije në paketim 2 litërsh të cilat ishin jo-origjinale. Bazuar në kontratë MFSK ka paguar shumë më shtrenjtë për pijet të cilat ishin të zotuara në kontratë ndërsa në anën tjetër kompania kishte ofruar pije të cilat në treg ishin deri në 30% më lirë. Asnjë gjë nuk është marrë në këtë drejtim për të vlerësuar shkaktarin. Pavarësisht kësaj, MFSK kishte bërë pagesat ashtu siç ka qenë e paraparë me kontratë pa i verifikuar specifikat e mallit, duke rezultuar në keqpërdorime të shumave të mëdha të parave me ose pa qëllim.³⁰ Për të njëjtën kompani që nga vitin 2009, Auditori i Përgjithshëm kishte dhënë një rekomandim rreth parregullsive të lidhjes së kontratave paraprake më atë kompani. Në ndërkohë, problematike mbetet po shtu fakti që edhe më tutje MFSK nguron që të i dërgoj paraprakisht për në shqyrtim tek Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen të FSK-së kontratat të cilat kalojnë shumën 1 milion Euro megjithëse një gjë e tillë është e paraparë me ligj.

Së fundmi, vlen të theksohet se Ligji i LPP-së nuk u'a ndalon institucioneve të Kosovës që të aplikojnë procedurat e përbashkëta të prokurimit për shërbimet dhe pajisjet për të cilat kanë nevojë. Për menaxhimin sa me efikas të prokurimit publik dhe për një kosto sa më të ulët të shpenzimit, institucionet e sigurisë duhet të fillojnë me hartimin e politikave për aplikimin e procedurave të përbashkëta të prokurimit publik duke i paraparë edhe specifikat e veçanta për të dyja institucionet e sigurisë. Kjo mund të rregullohet me anë të një marrëveshje ndërmjet dy institucioneve. Si Forca e Sigurisë së Kosovës po ashtu edhe Policia e Kosovës kanë nevojë për armatime dhe municione dhe pajisje të veçanta taktike operative, të cilat me aplikimin e procedurave të veçanta të prokurimit publik mund ti merrnin me çmim shumë më të ulët. Aplikimi i procedurave të përbashkëta *"Joint or Smart Procurement"* do ti mundësonte Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës standardizimin e armëve, municioneve dhe pajisjeve taktike-operative për nevojat e tyre. Sigurisht se kjo do të duhej të bëhej vetëm në pajisjet që detyrimisht do ti plotësonin nevojat e të dy institucioneve. Prokurimi i përbashkët nuk do të implikonte pajisjet specifike në funksion të karakteristikave të secilit institucion.

C. Trajtimi i Ankesave nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit

Deri më mesin e vitit 2013 OSHP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të ngritura nga operatorët e ndryshëm ekonomik në lidhje me dyshimet për keqpërdorim të procedurave të prokurimit nga ana e institucioneve të sigurisë. Mirëpo që nga mesi i vitit 2013 OSHP nuk e ka trajtuar asnjë ankesë të operatorëve ekonomik lidhur me lëshimet e mundshme të procedurave të prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktuese (institucioneve të Kosovës), për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve të bordit të OSHP-së. Momentalisht, sektori i prokurimit publik mbetet i pa-mbikëqyrur për shkak se Qeveria e Kosovës ende nuk e ka plotësuar anëtarët e bordit të OSHP. Kompletimi i bordit të OSHP-së është shumë i rëndësishëm kur kemi parasysh se Kosova e shpenzon mbi 700 mil të buxhetit me anë të prokurimit publik prej të cilave 20% e tyre shqyrtohen nga OSHP.


³⁰ Raporti i ZAP për MFSK 2012

Si pasojë e mos funksionimit të këtij institucioni, edhe ashtu jo shumë të pavarur po ndikon në dëmtimin e buxhetit publik duke lidhur kontrata me operator ekonomik të dëmshëm.³¹

Përkundër këtyre vështirësive dhe dyshimeve që mund të ekzistojnë rreth funksionimit të saj, ajo qka vlen të theksohet se gjatë viteve të kaluara OSHP ka trajtuar një numër të caktuar çështjesh që nderlidhen edhe me prokurimin në sektor të sigurisë. Më konkretisht, ky institucion ofron të dhëna se kanë qenë një numër i konsiderueshëm i ankesave të cilat ky institucion i ka trajtuar ndër vitet e që implikojnë ndër të tjera edhe MPB-në, PK dhe MFSK-në. Në vijim do të ipet një pasqyrë e shkurtër për numrin e rasteve të trajtuara nga OSHP në këto tri institucione.

Kështu, në vitin 2010 OSHP kishte pranuar 13 ankesa të ngritura kundër MPB-së. Prej tyre, 7 ankesa ishin vendosur në favor të MPB-së, 3 të tjera ishin dërguar në ri-tenderim; për 3 lëndë procedurat e vlerësimit kishin filluar nga pika zero; ndërsa për 2 lëndë të tjera operatorët ekonomik ishin tërhequr ankesat e tyre. Siç mund të shihet nga grafi në vijim, numër të përafërt të ankesave kishte pasur edhe në vitin 2010 dhe 2011.


Pasqyra e ankesave të ngritura nga operatorët ekonomik kundër MPB gjatë periudhës 2010 - 2012



Sa i përket Policisë, gjatë tri viteve të fundit, në krahasim me institucionet e tjera të sigurisë, OSHP punën më të madhe e kishte pasur këtë institucion. Madje, numri i ankesave të ngritura ndaj PK-së kishte mbërritur kulmin sidomos në vitin 2011, ku gjithsejtë OSHP kishte pranuar 26 ankesa ndaj operatorëve ekonomik, respektivisht 10 më shume se në vitin paraprak. Ndërsa gjatë vitit 2012, operatorët ekonomik kundër PK-së kishin ngritur gjithsej 16 ankesa. Statistikat përgjatë viteve 2010-2013 tregojnë se në shumë pak raste ankesat ishin vendosur në favor të operatorëve ekonomik. Andaj, është mjaftë shqetësues fakti se prej një numri të madh të rasteve, OSHP kishte vendosur qoftë ri-vlerësimin e tenderëve, anulimin ose dërgimin e kontratës në ri-tenderim. Grafi në vijim pasqyron vendimet e OSHP në lidhje me shqyrtimin e ankesave të drejtuara nga operatorët ekonomik kundër PK-së.

³¹ Disa nga udhëheqësit kryesor të OSHP-së në të kaluarën kanë qenë në pozita kyqe të kualicionit në pushtet, si shkak i saj edhe mund të lindin dyshime rreth pavarësisë këtij institucioni shumë të rëndësishëm.


Pasqyra e ankesave të ngritura nga operatorët ekonomik kundër PK-së gjatë periudhës 2010-2012



Në ndërkohë, gjatë vitit 2013 deri në muajin Shtator ndaj kësaj ministrie ishin ngritur gjashtë ankesa. Prej tyre OSHP kishte vendur 2 në favor të MPB-së, 2 të tjera rezultuan në favor të operatorëve ekonomik duke kthyer processin e tenderimit në rivlerësim ndërsa për 2 të fundit, për shkak të vonesave në formimin e bordit të OSHP (deri në Janar 2014) ende nuk është marrë ndonjë vendim.

Në fund, sa i përketë MFSK-së, në krahasim me dy institucionet e lartpërmendura, gjatë tri viteve të fundit numri i ankesave të ngritura ndaj kësaj Ministrie ka qenë me i vogël. Kështu, gjatë vitit 2010 ndaj kësaj ministrie ishin drejtuar vetëm 9 ankesa, ndërsa gjatë viti 2011 dhe 2012 në OSHP ishin drejtuar vetëm nga 7 ankesa. Po ashtu vlenë të përmendet se për shumicën e ankesave të ngritura nga operatorët ekonomik, vendimet e OSHP në shumicën e rasteve kishin shkuar në favor të MFSK-së, gjë që e dëshmon edhe tabela në vijim. Në ndërkohë që sipas burimeve të zyrtarëve të kësaj MFSK në vitin 2013 nuk kishte pasur fare ndonjë ankesë të ngritur nga ana e operatorëve ekonomik kundër kësaj ministrie.

MFSK: Pasqyra e ankesave të ngritura nga operatorët ekonomik gjatë periudhës 2010-2012



2.3. Funksionimi i sistemit të auditimit të brendshëm dhe inspektimit në Sektorin e Sigurisë

Auditimi i Brendshëm luan një rol të rëndësishëm për institucionet e sigurisë duke ndihmuar në rritjen dhe efikasitetin e kontrollit të brendshëm, ngritjen e performancës së institucioneve të sigurisë në aktivitetet e përgjithshme të tyre, racionalizimin e shpenzimeve të financave publike dhe qeverisjen institucionale në përgjithësi. Në Kosovë ky auditim është i decentralizuar, dhe përbëhet nga këto struktura: Njësitë e Auditimit të Brendshëm, Auditorët e Brendshëm, Komiteti i Auditimit, dhe Njësia Qendrore Auditimit (NjQ/AB) e cila funksionon pranë Ministrisë së Financave. Në vijim, në nën-seksione të veçanta do të elaborohet gjendja e Auditimit të Brendshëm në MPB, PK dhe MFSK.

A. Auditimi i Brendshëm në kuadër të MPB

Auditimi i brendshëm në MPB kryhet nëpërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm (në vijim do ti referohemi si njësia). Kjo njësi përballet me probleme të shumta duke përfshirë edhe numrin tejet të vogël të stafit e cila përbëhet nga drejtori dhe 3 zyrtarë të auditit. Megjithatë kur kemi parasysh sferën të cilën ata mbulojnë, ende mund të thuhet se sfida kryesore e kësaj njësie mbetet numri i vogël i personelit. Kjo automatikisht ndikon në zvogëlimin e volumit dhe cilësisë së auditimeve të kryera nga kjo njësi. E problemi vetëm sa shtohet kur kemi parasysh kompleksitetin e MPB-së si dikaster qeveritar, e cila përfshinë departamente të shumta dhe një numër të madh të agjencive të cilat janë nën mbikëqyrjen e saj.


Si rrjedhojë, në vitin 2012, Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte realizuar gjithsej 8 auditime të rregullta, ndërsa në vitin 2013 ishte realizuar vetëm 6 auditime të tilla.³² Si shkak i numrit të vogël të auditimeve të kryera, ato kryesisht ishin fokusuar në sektorët e vlerësuar si më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm duke anashkaluar sektorët e tjerë. Pra, kur kemi parasysh shumtën e mëdha të buxheti që kjo ministri shpenzon, numri i vogël i auditimeve të rregullta tregon një situatë alarmante brenda këtij institucioni. Për më tepër, gjetjet tregojnë që kontrolli *ex-ante* në këtë ministri është shumë i vogël, pothuajse joekzistent.³³

Një segment tjetër tejet brengosës është gjithashtu niveli i ulët i adresimit të rekomandimeve përkatëse të nxjerra nga njësia e departamenteve, sektorëve apo agjencive të audituara. Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm tregon se problemet e kontrollit të brendshëm të MPB-së po përsëriten në vazhdimësi dhe se mungon një ndërtim i qëndrueshëm i mekanizmave, si dhe të cilët do të garantonin shpenzim të drejtë dhe transparentë të fondeve publike brenda kësaj ministrie.

³² Intervistë me z. Driton Gashi- Sekretari Përgjithshëm i MPB-së data 15 Shtator 2013

³³ Fokus Grupi 21 Janar 2014

MPB: Niveli i implementimit të Rekomandimeve në vitin 2012



Ndërkohë, për shkak të numrit të vogël të stafit që kjo njësi ka, problem i madh qëndron edhe monitorimi i implementimit të rekomandimeve. Andaj, rritja e stafit të auditimit të brendshëm e me këtë edhe rritja e numrit të auditimeve të brendshme të zhvilluara nga kjo njësi është hap i domosdoshëm i parandalimit të keqpërdorimeve që mund të ndodhin edhe në të ardhmen në këtë ministri.

B. Auditimi i Brendshëm në kuadër të Policisë së Kosovës

Auditimi i brendshëm në Policinë e Kosovës është i ndarë nga ai i MPB-së. Auditimi i PK-së ushtrohet nga Njësia për Auditim të Brendshëm e Policisë së Kosovës, e cila përbëhet nga drejtori dhe 4 zyrtarë të tjerë. Auditori i brendshëm është nën varësi të ministrit dhe i raporton direkt atij. Siç shihet numerikisht, auditimi i brendshëm në polici deri tani qëndron më mirë se ai në MPB, mirëpo edhe këtu rritja e numrit të auditorëve të brendshëm do ta përmirësonte numrin e inspektimeve brenda PK-së. Kjo pasi që edhe në polici, numri i auditimeve të rregullta është mjaft i vogël në raport me buxhetin dhe shtrirjen e gjerë që ky institucion ka.

Si rrjedhojë, gjatë vitit 2011 në PK ishin realizuar gjithsejtë 16 auditime të brendshme. Në mesin tyre bënë pjesë edhe realizimi i projekteve janë implementuar në vitin 2010. Në gjë e tillë gjithsesi do të ketë ndikuar në uljen e cilësisë së auditimit në këtë institucion, duke qenë se njësia që kryente auditime më të shpeshta dhe më të detajuara ndaj shpenzimeve të buxhetit aktual i është dashur të merret me punë të papërfunduara në të kaluarën. Ndërkohë numri i rekomandimeve të adresuara gjatë këtij viti kishte qenë relativisht i dobët. Në total nga gjithsejtë 188 rekomandime të ofruara, PK kishte adresuar plotësisht vetëm 65, reth 69 ishin adresuar pjesërisht, kurse 31 rekomandime nuk ishin adresuar fare.³⁴


Situata paksa ishte përmirësuar në vitin 2012, ku njësia kishte arritur ti kryej gjithsejtë 14 auditime, dy më shumë se që ishin planifikuar.³⁵ Nga ky numër i inspektimeve, njësi kishte dalur me gjithsejtë 149 rekomandime në lidhje me menaxhmentin e PK-së. Rekomandimet e ofruara kryesisht lidhen me menaxhimin e prokurimit publik, planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe menaxhimin e flotës së Policisë së Kosovës. Megjithatë edhe në këtë vit, shqetësues mbetet

³⁴ Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës

³⁵ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për MPB dhe PK 2012

niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna, ku nga numri i rekomandimeve të paraqitura vetëm 59 rekomandime ishin implementuar plotësisht, 61 janë të implementuara pjesërisht si dhe 29 të tjera nuk ishin adresuar fare.³⁶ Rekomandimet të cilat ishin dhënë lidhur me flotën e Policisë së Kosovës e cila për vite të tëra nuk është përdorur nga PK për shkak të prishjeve të ndryshme. Kurse në vitin 2013, auditimi i brendshëm i PK-së kishte kryer një numër të pa-publikuar të auditimeve prej të cilave ishin nxjerrur rreth 152 rekomandime për menaxhmentin e Policisë së Kosovës. Nga ky numër i rekomandimeve, 79 janë implementuar tërësisht, ndërsa 61 të tjera mbeten mbeten në fazën e implementimit. Krahasuar me vitin 2012, vërehet një progres në adresimin e plotë të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Për më tepër, shkak për mungesën e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve në mënyrë sistematike është edhe numri i limituar i stafit i angazhuar në këtë njësi. Niveli i implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm në PK gjatë tri viteve të fundit është paraqitur edhe në formë grafike:

PK: Niveli i implementimit të rekomandimeve në gjatë periudhës 2011-2013



C. Auditimi i Brendshëm në MFSK


MFSK ka auditim të brendshëm i cili është i integruar i cili përbëhet nga stafi civil dhe ai i uniformuar. Sipas zyrtarëve të kësaj ministrie, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kapacitete të nevojshme për përmbushjen e detyrave të saj megjithëse edhe këtu vërehet një numër i vogël i stafit. Më konkretisht, kjo njësi përbëhet vetëm nga drejtori dhe dy zyrtar të auditimit. Pozita e shefit të auditit të brendshëm është A6 ekuivalent me pozitën e gjeneralit të brigadës brenda MFSK-së, e cila e bënë më të fuqishëm drejtorin e auditimit të brendshëm. Kjo njësi i raporton direkt ministrit dhe sekretarit të MFSK-së.

Njësia funksionon sipas planit strategjik dhe planit vjetor të auditimit i cili hartohet në duke bërë një vlerësim të riskut në bazë të të cilit hartohet edhe sektorët ku duhet të auditohet. Ndërsa edhe këtu vërehet një shmangie drejt adresimit të rekomandimeve nga ana e institucioneve përkatëse. Si rrjedhojë, sipas të dhënave të vitit 2012, vërehet se nga 35 rekomandime që kishte nxjerr çu-

³⁶ Raportimi i Drejtorit të Policisë së Kosovës para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri - 18 Janar 2013

ditmi i brendshme MFSK-së, vetëm 14 ishin adresuar plotësisht, apo 40% e tyre, ndërsa 21 nuk ishin adresuar fare, apo 60% e tyre. Niveli i adresimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga ana e MFSK-së nuk ishte në nivelin e kënaqshëm, duke vënë në dyshim gatishmërinë dhe progresin e MFSK-së në menaxhimin efiakas të shpenzimeve të parasë, si dhe duke ngritur dyshime se lëshimet në menaxhimin e fondeve publike mund të përsëriten nga viti në vit. Edhe në vitin 2013, procesi i shqyrtimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm nuk kishte ecur edhe aq mire. Nga 34 rekomandime të ofruara, vetëm 9 prej tyre janë adresuar plotësisht, apo 26% e tyre, kurse 25 prej tyre, apo 74%, janë në proces të adresimit apo nuk janë adresuar fare. Për më tepër, nëse i bëjmë një krahasim adresimit të rekomandimeve të ofruara nga auditori i brendshëm ndër vite për MFSK, atëherë vërejmë se në krahasim me vitin e kaluar kemi ngecje shumë të madhe në adresimin e rekomandimeve.

Niveli i adresimit të rekomandimeve të Auditimit të brendshëm në MFSK 2012-2013



Numri i vogël i rekomandimeve të konsideruara lenë hapësirë për të konstatuar se të gjeturat e auditimit të brendshëm në këtë ministri nuk i shqetësojnë edhe aq zyrtarët përkatës. Pavarësisht kësaj, njësia e brendshme e auditimit në MFSK mbetet njësia e vetme e auditimit në tërë administratën publike në Kosovë e cila haptazi shpreh shqetësimet e saj në lidhje me rreziqet e keqpërdorimeve dhe korrupsionit në procedurat e prokurimit publik në këtë ministri.³⁷

Përveç mos-konsiderimit të duhur të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe numrin e pamjaftueshëm të personelit, MFSK deri më tani nuk ka arritur asnjëherë të kryej auditime *ex-ante*, respektivisht të zhvilloj auditime të projekteve dhe aktiviteteteve të ndryshme buxhetore para apo gjatë zhvillimit të tyre. Si rrjedhojë, në mungesë të respektimit të duhur të rekomandimeve dhe pamundësisë së kryerjes së auditimeve *ex-ante* të ecurisë së implementimeve të projekteve të ndryshme, ka ardhur edhe deri të dyshimet për keqpërdorime të ndryshme siç është rasti i cekur në pjesën e prokurimit për furnizim me ushqim dhe pije.

Andaj është e nevojshme që në mënyrë emergjente kjo ministri të ngrit vigjilencën e zyrtarëve përkatës në respektimin e rekomandimeve të dala nga auditimi i brendshëm dhe të ngritë numrin e stafit të cilët punojnë në Njësinë për Auditim të Brendshëm. Rritja e numrit të stafit do të mundësoj

³⁷ Intervistë me një zyrtar të lartë të MFSK-së shtator 2013

jo vetëm kryerjen e auditimeve të planifikuara, por edhe ndërmarrjen e auditimeve të kohëpas-kohshme të planifikuara, duke fuqizuar kontrollin e shpenzimeve buxhetore në këtë Ministri.

Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nga ana e Institucioneve të Sigurisë

Përveq respektimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Njësive për Auditim të Brendshëm, institucionet e sigurisë janë të obliguara që të i zbatojnë opinionet dhe rekomandimet e dhëna edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) e cila është institucion i pavarur shtetëror i themeluar nga Kuvendi të Kosovës për të mbikëqyrur financat publike e që raporton në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit. ZAP kryen raporte të pasqyrave financiare dhe të performancave. Ndër të tjera ky institucion kryen auditime të rregullta vjetore edhe ndaj MPB-së (në kuadër të së cilës hyn edhe PK) dhe MFSK-së (në kuadër të së cilës hyn edhe Forca e Sigurisë së Kosovës).

Raportet e Auditorit kanë për qëllim matjen e progresit institucional në lidhje me ngritjen e cilësisë së menaxhimit dhe kontrollin e brendshëm të financave. Gjatë viteve të fundit ndjehet një ngritje bashkëpunimit ndërmjet ZAP dhe institucioneve të sigurisë në Kosovë. Tani Auditori i Përgjithshëm shihet si një institucion i cili i ndihmon institucionet e sigurisë në ngritjen e performancës së tyre.³⁸ Megjithatë edhe më tutje vërehen hezitime sa i përket implementimit të rekomandimeve të Auditorit nga ana e mekanizmave përkatës të institucioneve të sigurisë.

Niveli i Adresimit të Rekomandimit të ZAP nga ana e MPB dhe PK

Gjatë raportimeve në lidhje me MPB-në ku edhe më tutje vazhdon të përfshihet edhe PK, ZAP kishte vërejtur parregullsi të ndryshme si dhe anashkalim të rekomandimeve të saja nga ky institucion.

Kështu, në tre vitet e fundit opinioni i ZAP lidhur me aktivitetet buxhetore të MPB ishte i ndryshëm nga viti në vit si pasojë e lëshimeve të shumta që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve. Në vitin 2010 ZAP kishte dhënë opinion të kundërt (**ISSAI400**)³⁹ për pasqyrat financiare të MPB dhe PK për shkak se pasqyrat financiare të MPB-së për vitin 2010, në të gjitha aspektet materiale nuk prezantonin pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë për shkak të faktit se ishin jo të plota dhe të paqarta. Në vitin 2011 MPB kishte bërë një progres të limituar në menaxhimin e fondeve publike dhe për këtë vit ZAP kishte opinion të pakualifikuar (**SNISA 400**) për MPB dhe PK, i cili tregoi se pasqyrat financiare prezentonin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Kurse në vitin 2012 ZAP kishte dhënë opinion të pakualifikuar por me theksim të çështjes (**SNISA 400**) lidhur me informacionin jo të mirë të pasurisë së MPB-PK-së. Ndërsa gjetjet kryesisht kishin të bënin me parregullsi në prokurimi publik, menaxhimi i brendshëm jo edhe aq i mirë, dhe menaxhimi i pasurisë jo adekuat.⁴⁰ Në anën tjetër, përkundër rekomandimeve të ofruara nga ZAP për këto dy institucione, reagimi i tyre ka qenë mjaft i ngathët. Raportet e vitit përcjellës tregonin se nuk kishte pasur veprime konkrete nga këto dy institucione në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Auditori i përgjithshëm kishte ofruar 8 rekomandime për MPB dhe


³⁸ Intervistë me Artan Venharin Zv Auditor Gjeneral- Gusht 2013

³⁹ Raporti i ZAP për MPB-për vitin 2010

⁴⁰ Ibid:

PK në vitin 2010, prej të cilave një rekomandim ishte plotësuar, 4 rekomandime ishin në proces të plotësimit kurse 3 rekomandime nuk ishin plotësuar fare. Ndërsa në vitin 2011 ZAP kishte ofruar 10 rekomandime, prej të cilave vetëm 4 janë adresuar plotësisht të tjerat ishin në proces të adresimit apo nuk ishin adresuar fare. Në vitin 2012 ZAP kishte ofruar 10 rekomandime prej të cilave 2 ishin adresuar plotësisht, 8 ishin në proces të adresimit. Siç shihet trendi i adresimit të rekomandimeve të ZAP nga MPB dhe PK në tre vitet e fundit nuk është në nivelin e kënaqshëm. Këto institucione nuk e kanë ndërtuar një vazhdimësi në adresimin problemeve dhe sfidave me të cilat përballen këto institucione në menaxhimin e fondeve publike.

Trendi i Zbatimeve të Rekomandimeve të ZAP nga ana e MPB dhe PK




Niveli i Adresimit të Rekomandimit të ZAP nga ana e MFSK

Sipas raporteve të ZAP, MFSK gjatë tri viteve të fundit kishte pasur performancë më pozitive duke dhënë opinionin e pakualifikuar për këtë ministri. Kështu, për vitin 2011 ZAP kishte ofruar 9 rekomandime për pasqyrat financiare të MFSK-së. Prej tyre 5 rekomandime ishin adresuar plotësisht, kurse 4 tjera ishin në proces të adresimit apo nuk ishin adresuar fare.⁴¹ Kurse në raportin vjetor të publikuar për vitin 2012 ZAP kishte ofruar 8 rekomandime për MFSK prej të cilave një rekomandim ishte adresuar plotësisht kurse pjesa tjetër ishte në proces të adresimit apo nuk ishte adresuar fare. Ndërsa në atë raportin vjetor i cili mbun vitin 2013, ZAP-i kishte ofruar 16 rekomandime prej të cilave vetëm 6 prej tyre janë adresuar plotësisht kurse pjesa tjetër nuk ishin adresuar.

⁴¹ Raporti i ZAP për MFSK për vitin 2011

Trendi i Zbatimeve të Rekomandimeve të ZAP nga ana e MFSK për periudhën 2011-2013



Andaj, ashtu edhe siq po shihet edhe në MFSK nuk kishte pasur konsistencë të mjaftueshme në adresimin e rekomandimeve të ZAP. Për më shumë gjatë kësaj periudhe kishte pasur rritje të numrit të rekomandimeve të ZAP për MFSK, dhe në të njëjtën kohe kjo është përcjelle me ngecje në zbatimin e rekomandimeve nga ana e MFSK-së.

Rekomandimet:

- Të planifikohet në mënyrë precize dinamika e ekzekutimit të shpenzimeve me qëllim që të shmangët numri i madh i pagesave të koncentruara në një periudhë të shkurtër të fundit të vitit apo edhe bartjeve të panevojshme të shpenzimeve të caktuara në vitin vijues me qëllim të lehtësimit të ushtrimit të mbikqyrjes së shpenzimit të parasë publike edhe në sektor të sigurisë;
- Institucionet e sigurisë duhet të duhte të themelojnë grupe punuese ndër-institucionale me qëllim të identifikimit të mundësive për aplikim të procedurave të përbashkëta të prokurimit në blerjen e pajisjet të veçanta (siç janë: Armatimi, municioni si dhe pajisjet tjera taktike-operative të forcave);
- PK-ja gradualisht duhet të fillojë me standardizimin e pajisjeve dhe flotës së saj e cila do ta bënte më të lehtë mirëmbajtjen dhe menaxhimin e përgjithshëm të pajisjeve dhe flotës së Policisë së Kosovës;
- Numri i zyrtarëve që punojnë në Njesite e Auditimit të Brendshëm duhet të rritet në mënyrë urgjente me qëllim të mundësi të shtimit të numrit të auditimeve të rregullta si dhe atyre *ex-ante*.
- Institucionet e sigurisë duhet të sigurohen që rekomandimet të cilat dalin nga Njesitë e auditimit të brendshëm dhe ato të ZAP të konsiderohen në mënyrë të përpikët me qëllim të parandalimit të përsëritjes së problemeve edhe në vitet vijuese.
- Institucionet e sigurisë duhet që të bëjnë publike raportet e auditimit të brendshëm në uebfaqet e tyre zyrtare në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare dhe atë për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë.
- Njësia për auditim të brendshëm duhet të ngris efikasitetin me qëllim të identifikimit dhe hetimit të rasteve që kanë të bëjnë me keqpërdorime në prokurim publik
- Kuvendi i Kosovës në të ardhmen duhet të parashih ndryshimin e ligjit të Prokurimit Publik dhe i cili duhet të ketë një nen të veçantë i cili e rregullon sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, e që është standari i cili duhet të plotësohet në rrugetimin e Kosovës drejt integritimit në NATO
- Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe për Mbikëqyrjen e FSK-së duhet që në përputhje e mandatin e tij, që të gjitha kontratat të cilat kalojnë shumën 1 milion Euro para miratimit dhe fillimit të implementimit të tyre, të marrinë pëlqimin e komisionit.
- Edhe pse Qeveria e Kosovës buxhetin për Policinë e Kosovës e ndanë në kuadër të buxhetit të MPB, auditori i përgjithshëm duhet që raporin për pasqyrat financiare të PK-së ti bëjë ndaras nga ai i MPB-së. Raportet për pasqyrat financiare të PK-së duhet të hartohen ndaras nga ato të MPB-së.

Bibliografia:

Legjislacioni:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008
2. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike- 2012/2013
3. Ligji për Prokurimin Publik ne Kosovë 2011
4. Ligji për Shërbyesit Civil 2010
5. Ligji për Auditimin e Brendshëm 2009
6. Rregullorja për zhvillimin e procedurave te sigurisë http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Per_Zhvillimin_e_Procedures_se_Verifikimit_te_Sigurise.pdf

Raportet dhe Publikimet:

1. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MPB për vitin 2010
2. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MPB për vitin 2011
3. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MPB për vitin 2012
4. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MFSK për vitin 2010
5. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MFSK për vitin 2011
6. Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për MFSK për vitin 2011
7. Raporti vjetor i punës i Policisë së Kosovës për vitin 2011
8. Raporti vjetor i punës i Policisë së Kosovës për vitin 2012
9. Raporti vjetor i punës i Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2011
10. Raporti vjetor i punës i Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2012
11. Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së mirë në Sektorin e Sigurisë në Kosovë –QKSS-2012
12. Raporti vjetor i punës i Organit Shqyrtues të Prokurimit
13. Raporti i grupit punues të Komisionit Për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për menaxhimin e financave publike nga institucionet e sigurisë në Kosovë 2013
14. Procesverbali i Interpelancës së Ministrisë të Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi në Kuvendin e Kosovës në vitin 2012
15. Lëvizja FOL- Raporti i Monitoruesit të Prokurimit Publik Janar Dhjetor 2011
16. Barometri Kosovar i Sigurisë – QKSS 2012
17. Barometri Kosovar i Sigurisë- QKSS 2013
18. Barometri Kosovar i Sigurisë – QKSS Dhjetor 2013
19. Artikulli hulumtues i Gazetës “Jeta në Kosovë” <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,6656>
20. Raportimi I Drejtorit të PK para Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri data 18 Janar 2013
21. Raportimi i Ministrisë të MPB para komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike- Korrik 2013
22. Raporti Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK rreth mbikëqyrjes së financave publike në Sektorin e Sigurisë në Kosovë 2013
23. Raporti i Inspektoratit Policor të Kosovës- Raport Inspektimi 2012 <<https://ipk.rks-gov.net/Reports/raport21.pdf>>

Intervistat:

1. Intervistë me z. Driton Gashi- Sekretar i Ministrisë së Punëve të Brendshme - Gusht 2013
2. Intervistë me z. Shkelzen Syla – Sekretar i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës 13-01-2014
3. Intervistë me z. Fidan Kalaja Menaxher i Programit në Lëvizjen FOL- 15-11-2013
4. Intervistë me z. Artan Venhari –Zyra e Auditorit të Përgjithshëm- Gusht 2013
5. Intervistë me z. Valbon Bytyqi- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – Gusht 2013
6. Intervistë me z. Astrit . U.D Udhëheqësit të Prokurimit Publik në MPB Gusht 2013
7. Intervistë me Bashkim Berisha Udhëheqë i Auditimit të Brendshëm në MPB Gusht 2013
8. Intervistë me Drejtoreshën për Buxhet dhe Financa në MPB znj Drita Xheladini- Gusht 2013
9. Intervistë elektronike (email) me Hamdi Hyseni- Departamenti për Buxhet dhe Financa në Policinë e Kosovës 18-09-2013

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

336.722.8(496.51)

Përteshi, Skender

Accountability or not ? Managing the public funds in Kosovo Security Sector /
Skender Përteshi. - . - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2014. - 33
f. : ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Bibliography : 31-33

ISBN 978-9951-8782-9-6

www.qkss.org

ISBN 978-9951-8782-8-9

